

SHKOLLA “ANDREW JACKSON”
1213 S. 12TH STREET
PHILADELPHIA, PA 19147

22/5/14

I dashur Prind/Kujdestar:

Me hidhërim të madh ju bëjnë me dije për vdekjen e papritur të një nxënësi të klasës së 1^{re}. Ne duam t’ju informojmë gjithashtu se Ekipi i Përballjes së Urgjencave/Krizave, i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias po zhvillon sot aktivitet mbështetës për këshillimin e fëmijëve në shkollën tonë. Këshilltarë që trajtojnë rastet e fatkeqësive po bisedojnë me nxënësit sipas rastit në mënyrë individuale ose/edhe me grupe të vogla.

Një humbje e papritur si kjo, mund të ketë një ndikim të thellë tek nxënësit. Për këtë arsye, ne ju nxitim të dëgjoni fëmijën tuaj, si dhe të diskutoni me të për ndjenjat e tij dhe reagimin për këtë humbje. Vdekja e papritur është gjithmonë e vështirë për t’u kuptuar dhe fëmija juaj mund të përjetojë shenja të një stresi. Disa prej këtyre shenjave përfshijnë:

- Pamundësi për t’u përqëndruar
- Nervozizëm ose agresivitet në rritje
- Izolim dhe tërheqje nga aktivitetet normale me shokët dhe miqtë
- Ndjenjë faji
- Frikë dhe shqetësim
- Ndryshime në orarin e gjumit, ose të oreksit

Në rastet kur vëreni ndryshime të pazakonta në sjelljen e fëmijës, ose të humorit të tij, ju lutemi kontaktoni për asistencë të mëtejshme Shkollën “**Andrew Jackson**” në numrin **215-952-6223**. Ju lutemi mos ngurroni të telefononi në rast se keni ndonjë pyetje. Mundësi të tjera ju ofrohen në pjesën e pasme të kësaj letre.

Sinqerisht,

Lisa Ciaranca-Kaplan
Drejtoreshë